



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština -Municipality of Prishtina**



**E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T**

**të mbledhjes së tetë të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 24.10.2022,  
duke filluar në orën 10:00.**

**Në mbledhje morën pjesë:** Fehmi Kupina, kryesues i Komitetit, anëtarët e Komitetit: Arbnora Berisha, Mirsad Vitia, Gëzim Sveçla, Nora Kelmendi, Milazim Vitija, Jeta Rafuna, Donjeta Dragusha, Leutrim Retkoceri dhe Shegë Beqiri.

**Mungoi :** Bahri Gashi.

**Në mbledhje ishin të pranishëm edhe:** Valbona Ahmeti - Makolli, drejtore e Drejtorisë së Financave, Doruntinë Maloku, drejtore e Drejtorisë së Pronës, Bersant Beka, drejtor i Drejtorisë së Administratës, Granit Rugova, drejtor i Drejtorisë së Sportit dhe Osman Bllaca.

Para së të fillonin më diskutimet për pikat e rendit të ditës, Doruntinë Makoku propozoi që të futet si pikë e rendit të ditës "Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Shukrije Bajgorës, Muhamed Sadikut, Adnan Sadikut, NPSH "CONIN" dhe "Vëllezërit Asllani", SHPK.

Po ashtu, tha se kemi kërkesë, edhe një lëndë është duke u përgatitur në Drejtorinë e Pronës për një këmbim. Nëse arrijmë ta kompletojmë lëndën për Kuvend, do ta fusim në rend të ditës pikën "Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale për FSHMN-në". Ajo informoi se janë në proces të rregullimit të një parcele në Vaternik, që është dedikuar për ndërtimin e objekteve komunale, për ndërtimin e objektit të Odës së Mjekëve, nëse arrijmë ta kompletojmë lëndën edhe këtë do ta fusim në rend dite.

**Nora Kelmendi** u shpreh se nuk mundesh ti me sjell në seancë këmbime ose dhënie në shfrytëzim dhe në atë momente ne me i shikuar. Unë nuk mundem gjatë seancës me i shikuar të gjitha dokumentet që na sillen.

**Gëzim Sveçla** tha se Ligji për qeverisje lokale thotë se 7 ditë para mbledhjes duhet dërguar materialin.

**Doruntinë Makoku** theksoi se Nora ka të drejtë plotësisht, mirëpo edhe unë jam në një pozitë shumë të palakmueshme, për shkak se kemi kërkesë prej institucionit.

**Granit Rugova** bëri të ditur se tani është 100-vjetori i themelimit të klubit "Prishtina" dhe 35 - vjetori i themelimit të klubit "Plisat", andaj tani duhet propozuar për t'u futur si pikë e rendit

**Faqe1nga11**

të ditës për subvencionim, mirëpo ende nuk ka ardhur kërkesa, apo duhet ardhur kërkesa pastaj për mbledhjen e radhës të futet si pikë e rendit të ditës.

**Gëzim Sveçla** theksoi se kjo mund të futet si pikë e rendit të ditës në fillim të seancës me propozimin e kryetarit, mirëpo duhet shikuar mënyrën ligjore si është më mirë.

**Osman Bllaca** dha sqarime, duke thënë se tash ne nëse i ndajmë mjetet siç ka vepruar ndonjë komunë tjeter ndahen për OJQ, edhe OJQ-ve iu japim subvencione. Tash edhe "Plisat", edhe "Prishtina" dallojnë këtu, "Plisat" janë OJQ e "Prishtina" është Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara (SHPK), janë faktikisht biznes juridikisht me letra. Ne duhet të dimë ta definojmë se si me ua ndarë, sepse nuk mundemi me një linjë me ua vendosur të dyve. Kështu që duhet dy vendime me i marrë dhe duhet me pasur shumë kujdes.

**Gëzim Sveçla** tha se duhet me dy vendime me i subvencionuar.

**Jeta Rafuna** propozoi që të futet si pikë e rendit të ditës pika "**Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare për NPL "Kuzhina Qendrore"**".

**Leutrim Retkoceri** propozoi që të futet si pikë e rendit të ditës "**Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare për NPL" Hortikultura"**".

**Bersant Beka** propozoi që të futet si pikë e rendit të ditës "**Propozimvendimi për caktimin e komisionit për udhëheqjen dhe koordinimin e punës në terren për përzgjedhjen e këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane**".

**Gëzim Sveçla** parashtroi çështjen e shujtës, që është kthyer vendimi se është i paligjshëm, andaj a duhet anuluar vendimi në Kuvendin e Komunës, se 30 ditë ke kohë ose shkon në Gjykatë.

**Luljeta Selimi** tha se konfirmimi na ka ardhur pas afatit.

**Gëzim Sveçla** bëri të ditur se janë dy mundësi, nëse ka ardhur konfirmimi pas afatit, i bie se është i plotfuqishëm dhe nëse vendimi është i plotfuqishëm, atëherë ju duheni me e zbatuar atë vendim dhe me i qitur shujtat për punëtorë për vitin 2022 ashtu si është marrë vendimi.

**Leutrim Retkoceri** dha sqarime, duke thënë se nga situatat dhe praktikat e mëhershme, nëse organi i shkallës së dytë, që në këtë rast i bie MAPL-ja, jep vendim për një akt, atëherë akti nën të, që i bie Kuvendi Komunal, nuk mundet me e kthye dhe me e shpallur të paligjshëm një vendim që e ka shpallur organi i shkallës së dytë ose me e anulua atë vendim. E rekomandimi ka të bëjë me përmirësimin ose plotësim-ndryshimin e atij vendimi për me e ridërguar edhe njëherë.

**Kryesuesi** tha se në seancë Zyra ligjore e sqaron më mirë.

Më propozimin e dhënë, kryesuesi e hodhi në votim këtë

#### R E N D TË D I TË S:

- 1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së shtatë të Komitetit për Politikë dhe Financa;**

---

Faqe2nga11

2. Raporti i financiare buxhetore i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 korrik - 30 shtator, 2022 (TM3);
3. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale, me pronën e paluajtshme në pronësi të "Kompania e Re Dardania - Arbëria" SHPK (qirambajtje), Rizah, Metush, Bekim, Bashkim dhe Artin Deshishku;
4. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale, me pronën e paluajtshme në pronësi të "Pozhegu Brothers", SHPK;
5. Informatë lidhur me Raportin vjetor të komisionit të aksionarëve të NPL "Pallati i Rinise";
6. Informatë lidhur me Raportin vjetor të komisionit të aksionarëve NPL "Hortikultura";
7. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Shukrije Bajgorës, Muhamed Sadikut, Adnan Sadikut, NPSH "CONIN" dhe "Vëllezërit Asllani", SHPK;
8. Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare për NPL "Kuzhina Qendrore";
9. Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare për NPL "Hortikultura";
10. Propozimvendimi për caktimin e komisionit për udhëheqjen dhe koordinimin e punës në terren për përgjedhjen e këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane;
11. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se u miratua rendi i ditës.

#### Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së shtatë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së shtatë të Komitetet për Polikë e Financa.

#### Pika e dytë

Raporti finanziar buxhetore i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 korrik - 30 shtator, 2022 (TM3).

**Valbona Ahmeti - Makolli** dha sqarime, duke thënë se tek të hyrat vetanake, që në muajin shtator ka pasur një rënje drastike për shkak të grevës së stafit civil që ishte në grevë në Komunë, përndryshe të hyrat janë në realizim sipas planit, përjashtim këtyre 5 javëve që kanë qenë, ka qenë shuma më e vogël sesa ajo që kemi planifikuar. Tani në tetor të shohim, por dy javët e para veç është vërejtur një fluks i madh dhe pagesat janë shkumë më shumë. Sa i përket realizimit për këtë periudhë që po raportojmë, "paga dhe mëditje" janë realizuar 73%, "mallra dhe shërbime" 61%, "komunale" 58%, "subvencione" 61% dhe "investime kapitale 8.7%" të realizimit të tyre.

**Gëzim Sveçla** u shpreh se vërejtjet tona për raport finanziar për TM3 do t'i shpalosim gjatë seancës së Kuvendit.

---

#### Faqe3nga11

**Jeta Rafuna theksoi se në seancë do të diskutojmë.**

**Leutrim Retkoceri** u shpreh se ne e kemi parë që në raport shifrat janë jashtëzakonisht të ulëta, si në ekzekutim dhe në arkëtim. Njëren prej arsyet përmendët, që ka qenë greva, por arsyet tjetër është a ka të bëjë edhe me vonesën e rishikimit të buxhetit, ose mungesën e rishikimit të buxhetit se kjo ndikon, anulimin e kontratave.

**Valbona Ahmeti - Makolli** tha se anulimin ka filluar drejtori, mirëpo në momentin kur qeveria ka lajmëruar subvencionimin prej 20% të kompanive, ne e kemi ndërprerë.

**Gëzim Sveçla** pyeti se si bëhet shkëputja dhe si po bëhet, p.sh. pagesa e punëve të ekzekutuara deri më tanë.

**Valbona Ahmeti - Makolli** tha se bëhet prerja e menaxherit deri ku ka shkuar puna, bëhet pagesa, pas pagesës me pëlqimin e të dyve, është një kohë në prokurim ku të dy palët pajtohen për të mos shkuar në Gjykatë.

**Leutrim Retkoceri** pyeti se a ka penallti.

**Valbona Ahmeti - Makolli** tha jo nëse pajtohen të dy palët, nëse veç shkon e njëanshme, atëherë po.

**Leutrim Retkoceri** pyeti se sa për qind të kontratave deri tanë janë anuluar.

**Valbona Ahmeti - Makolli** tha se për mëndësh nuk e di, por mundem me e pyetur Zyrën ligjore dhe për mbledhjen e Kuvendit me iu lajmëruar.

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Raporti i financiare buxhetore i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 korrik - 30 shtator, 2022, (TM3) dhe dërgohet në Kuvend për diskutim.**

**Pika e tretë**

**Propozimvendimi** për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale, me pronën e paluajtshme në pronësi të "Kompania e Re Dardania - Arbëria", SHPK (qirambajtje), Rizah, Metush, Bekim, Bashkim dhe Artin Deshishku.

**Doruntinë Maloku** dha sqarime, duke thënë se është një prej lëndëve që datojnë në Drejtorinë e Pronës, mirëpo për shkak të shpronësimit që është bërë, parcelat kanë pasur një barrë tatimore të cilën nuk kemi arritur ta heqim bashkë me AKP-në, të cilat procedura i ka ndjekur AKP-ja sipas vendimit të shpronësimit dhe kjo procedurë ka përfunduar diku në periudhën kur ka qenë greva e punonjësve të Komunës së Prishtinës. Për këtë shkak kjo lëndë ka mbetur pa shkuar në Kuvend, sepse nuk janë pastruar parcelat nga barra tatimore, për shkak se ATK-ja e ka vonuar si provë bashkë me AKP-në.

**Nora Kelmendi** pyeti a e kemi këtu departamentin ligjor.

**Kryesuesi** u përgjigj se këtu nuk e kemi, por kam kërkuar opinion prej Zyrës ligjore.

**Nora Kelmendi** pyeti se për çka po i kërkon opinion ligjor.

**Kryesuesi** u përgjigj, duke thënë se për çdo këmbim që bëhet unë kërkoj opinion ligjor nga Zyra ligjore.

**Doruntinë Maloku** theksoi se zakonisht këto këmbime që po vijnë nuk janë me kërkesë direkt të kryetarit, sepse me ligj ju e dini se janë dy mundësi se si bëhet kërkesa, njëra është kur Drejtoria e Urbanizmit apo Drejtoria e Investimeve Kapitale për shkak të rrugës së planifikimit, kushteve urbanistike, e parashevë një këmbim të tillë, por për shkak se plani

rregullues e përcakton interesin publik dhe këto lëndë janë në atë formë. Është edhe forma tjetër, ku për shkak të interesit publik kryetari kërkon që me filluar një këmbim, d.m.th brenda blokut ndërtimor zakonisht këto këmbime që bëhen vijnë në bazë të kushteve të Drejtorisë së Urbanizmit.

**Gëzim Sveçla** pyeti drejtoreshën se cili është mendimi juaj për këtë këmbim.

**Doruntinë Maloku** në aspektin e qira mbajtjes, unë vet i kam pyetur zyrtarët e Drejtorisë së Pronës se a ka pasur raste më herët kur janë bërë këmbime të tilla, ata thanë që po.

**Nora Kelmendi** kerkoi me ju sjell ndonjë rast që ta shohin ose me ju dërguar me e-mail sepse nuk e mbanë mend.

**Doruntinë Maloku** tha po mundem, për secilin këmbim ta keni parasysh ne gjithmonë e dërgojmë në Zyrën Ligjore, nuk e dërgojmë në shërbimin e Kuvendit pa e dërguar në Zyrën Ligjore.

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale, me pronën e paluajtshme në pronësi të "Kompania e Re Dardania - Arbëria", SHPK, (qirambajtje), Rizah, Metush, Bekim, Bashkim dhe Artin Deshishku dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

#### **Pika e katërt**

**Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale, me pronën e paluajtshme në pronësi të "Pozhegu Brothers", SHPK.**

**Doruntinë Maloku** dha sqarime, duke thënë se diku nga fundi i muajit gusht "Pozhegu Brothers" ka bërë një kërkesë në Drejtorinë e Pronës, ku ka treguar se i ka eliminuar disa çështje që i ka pasur lidhur me lëndën dhe ka kerkuar që me u proceduar, prandaj meqenëse gjithçka është në rregull e kemi proceduar.

**Leutrim Retkoceri** tha se te Vendimi i pikës 3 dhe te Vendimi i pikës 4, është një pikë që po ndryshon.

**Doruntinë Maloku** sqaroi, duke thënë se është rregulluar sepse ka qenë një gabim teknik, Zyra ligjore na ka bërë vërejtje dhe e kemi rregulluar gabimin.

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale, me pronën e paluajtshme në pronësi të "Pozhegu Brothers", SHPK, dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

#### **Pika e pestë**

**Informatë lidhur me Raportin vjetor të komisionit të aksionarëve të NPL "Pallati i Rinisë".**

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Informata lidhur me Raportin vjetor të komisionit të aksionarëve të NPL "Pallati i Rinisë" dhe dërgohet në Kuvend për diskutim.**

## Pika e gjashtë

**Informatë lidhur me Raportin vjetor të komisionit të aksionarëve të NPL "Hortikultura".**

**Leutrim Retkoceri** theksoi se sa i përket informatave është mirë si praktikë që pe e bëni, mirëpo raportim këtu nuk kemi, por kemi informatë sa i përket gjendjes që në kushte normale duhet me raportuar aksionarët për gjendjen. 90% e rasteve raportimet ose informatën kemi me pasur në atë si janë ndërmarrjet. Ndërmarrjet janë keq, me ligj ndërmarrjet e kanë planin e biznesit, tash në këtë fundmuaji që e bëjnë ata, kanë me raportuar në Kuvend për këtë plan të biznesit, jo për plan të biznesit të mandatit të kaluar, se kjo nuk i bie që është raport i këtij Kuvendi. Në kushte normale, kjo do të duhej filluar të paktën në gjashtëmujorin e parë, por me qenë raportimi në Kuvend.

**Gëzim Sveçla** u shpreh se duhet pasur informacione për gjendjen e ndërmarrjes.

**Mirsad Vitia** tha se ne i dimë aksionarët e rinj ku janë emëruar, por për gjendjen çka ka ndodhur aty pse mos me qenë të informuar.

**Milazim Vitija** u shpreh se në bazë të përvojave të kaluara si i kemi pasur raportimet, janë bërë prej marsit, do të thotë çdo aksionar ka raportuar për vitin paraprak, është dashur me raportuar aksionarët e kaluar që kanë qenë këtu me kërkesën e tuaj Gëzim, është bërë që të jepet një informatë për ndërmarrjet. Duhet ditur asamblistët gjendjen e ndërmarrjes, se në çfarë gjendje i kemi ndërmarrjet komunale aksionarët do të raportojnë në vitin e ardhshëm, pasi të mbylltet viti, në muajin mars. Në mars kemi me raportuar për të gjitha ndërmarrjet.

**Gëzim Sveçla** tha se këto raporte që kanë me ardhur, pse nuk i kemi ne sot, që eventualisht diçka çka kemi të paqartë me i pyetur ata persona të cilët kanë me raportuar në seancë në bazë të atij rapporti që na ofrohet.

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Informatë lidhur me Raportin vjetor të komisionit të aksionarëve të NPL "Hortikultura" dhe dërgohet në Kuvend për diskutim.**

## Pika e shtatë

**Propozimvendimi** për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Shukrije Bajgorës, Muhamed Sadikut, Adnan Sadikut, NPSH "CONIN" dhe "Vëllezërit Asllani", SHPK.

**Doruntinë Maloku** u shpreh se është një lëndë e cila ka pasur një problem me parcela dhe për shkak të shqetësimeve që investitori i ka pranuar nga banorët, duke i bërë presion që me përfunduar më shpejt, ka bërë kërkesë në Drejtori të Pronës që mu proceduar sa më shpejt kjo lëndë, për shkak të ruajtjes së marrëveshjet me banorët, është me kushtet urbanistike njëjtë sikur tjerat.

**Kryesuesi** paraqiti një kërkesë për drejtoreshën, duke thënë se për këtë vendosim në Kuvend, por për të ardhmen mbesin, me të vërtetë janë pika të ndjeshme, ju kisha lutur mos me i lënë me i furur në KPF, vetëm për ndonjë rast të domosdoshëm, ose me pasur ndonjë mbledhje të jashtëzakonshme.

## Faqe6nga11

**Nora Kelmendi** tha e shqyrtojmë, e shikojmë, mirëpo a keni biseduar me departamentin ligjor për këtë pronë, PSH - ujërat ai i menaxhon Komuna apo PSH, ujërat menaxhohen nga Agjencia Kosovare e Privatizimit.

**Doruntinë Maloku** bëri të ditur se e ka dërguar edhe këtë për ligjshmëri, d.m.th. për opinion ligjor. Asnjë lëndë nuk vjen në Kuvend pa e marrë konfirmimin prej Zyrës ligjore. Sa i përket menaxhimit të PSH- ujërat, ato menaxhohen nga komunat përkatëse.

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Shukrije Bajgorës, Muhamed Sadikut, Adnan Sadikut, NPSH "CONIN" dhe "Vëllezërit Asllani", SHPK, dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

#### Pika e tetë

**Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare për NPL "Kuzhina Qendrore".**

**Jeta Rafuna** dha sqarime për këtë, duke thënë se ndërmarrja publike "Kuzhina Qendrore" në aspektin organizativ dhe financiar, në janarin e këtij viti është pavarësuar tëresisht, është konsoliduar, tash i ka hyrë procesit të zhvillimit, duke investuar edhe në procese kapitale, që në një të ardhme të afërt mendoj se do të sigurojë një pavarësi jo vetëm financiare, por edhe funksionale. Kërkesën prej tyre e kemi marrë sepse ata janë duke e zhvillu tregun kapital për të investuar në instalimin e paneleve solare në klubin e ndërmarrjeve, për këtë ata kanë kërkuar një subvencion nga Komuna që arrin vlerën 35 mijë euro.

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare për NPL "Kuzhina Qendrore" dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

#### Pika e nëntë

**Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare për NPL "Hortikultura".**

**Leutrim Retkoceri** dha sqarime, duke thënë se kjo ndërmarrje qëndron jashtëzakonisht keq me mekanizëm, mjete të punës, me pikat operative që i ka në terren. Në bashkëpunim me kryetarin e Komunës, tash është edhe një qendër që do ta menaxhojë, është "Deponia e Dheut" në pjesën e Matit dhe mungojnë pajisje për të cilat do ta rregullonin këtë pjesë. Është një listë me më shumë se 30 nevoja që i kanë, si në pajisje, mjete të punës apo mekanizim, dhe për këtë ata kanë kërkuar një subvencionim me vlerë 100 mijë euro.

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare për NPL "Hortikultura" dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

## Pika e dhjetë

**Propozimvendimi për caktimin e komisionit për udhëheqjen dhe koordinimin e punës në terren për përzgjedhjen e këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.**

**Bersant Beka** tha se sa i përket këtij propozimvendimi për caktimin e komisionit, kishte qenë mirë që unë me e dërguar edhe një e-mail edhe emrat e personave të komisioneve që dalin prej partive politike nga Kuvendi, që me e propozua në Kuvend dhe me e votuar, në mënyrë që të fillojnë procedurat për aranzhimin e takimeve me qytetarë. Meqenëse ne duhet të dërgojmë edhe një e-mail tek Shoqëria civile me propozuar, sepse është i propozuar edhe një anëtar prej tyre, një prej ekzekutivit, katër prej Kuvendit, edhe një në secilin vend ku mbahet.

**Gëzim Sveçla** tha se emrat ti paraqesim në seancën e Kuvendit.

**Bersant Beka** theksoi se duhet me i futë të gjithë organizatat e Shoqërisë civile që me na propozua edhe ata dikë. Pasi të marrim propozimin e tyre, në Kuvend e bëjmë propozimin prej secilës parti kush vjen, bëhet komisioni dhe fillojmë ta përpilojmë agjendën për zgjedhje.

**Jeta Rafuna** parashtroi dy pyetje për drejtorin. Ata katër që kanë me qenë prej Kuvendit komunal, si ka me qenë struktura gjinore, sepse me sa e di unë, duhet me qenë 50% apo 30%. Nën dy, unë kërkoj që ky komision që del prej Kuvendit, me u gjetur mënyra për me u paguar. Mendoj që paralelisht të bëhet një vendim, ose t'i subvenciononi, ose prej mallrave dhe shërbimeve, por ky komision të paguhet.

**Bersant Beka** tha se në momentin që formohet komisioni, ne kemi biseduar edhe me kryetarin, do ta gjejmë një zgjidhje bashkë me Drejtoreshën e Financave.

**Valbona Makoll** u shpreh se nëse është shuma e caktuar ne e shohim, e konfirmojmë a i kemi ato mjete dhe me atë të njëjtin vendim.

**Leutrim Retkoceri** tha se çështja e pagesës është pikë tjetër, nëse futet kjo e komisionit është një pikë, nëse futet forma e pagesës është pikë tjetër. Gjithashtu edhe forma se si duhet me u subvencionuar janë dy pika të ndryshme. Nëse është koha deri në seancë, unë mendoj se nuk është kohë e mjaftueshme me gjetur këtë formën se si me e sjellë në seancë për votim. Nëse bëhet komisioni, tek e fundit mundet me u bërë, por forma e pagesës pa ardhur si propozim, si pikë nuk mundet me ndodhur.

Njëherësh ai pyeti se a është kthyer interpretim nga MAPL-ja, a ka kaluar si rregullore, a ka pasur vërejtje, a është publikuar.

**Luljeta Selimi** u përgjigj se nuk ka pasur vërejtje, por është publikuar, në rregull është gjithçka sa i përket rregullores.

**Leutrim Retkoceri** parashtroi edhe një pyetje. Anëtarët që caktohen nga Shoqëria civile, a keni menduar me i zgjedhur, me i sjellë në seancë për votim, apo i bëjmë ndaras, të Kuvendit dhe të Shoqërisë civile.

**Osman Bllaca** dha sqarime.

**Bersant Beka tha se anëtari i shtatë, që nuk e dimë, mbetet si i shkruar, si përfaqësues i fshatit, vendbanimit, mandej aty për aty zgjidhet, që nuk ka të drejtë vote.**

**Kryesuesi konstatoi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për caktimin e komisionit për udhëheqjen dhe koordinimin e punës në terren për përzgjedhjen e këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

### Të ndryshme

**Gëzim Sveçla u shpreh se atë ditë në seancë kërkova opinionin e Zyrës Ligjore lidhur me shujtat, Zyra ligjore tha që nuk bën me votua kështu.**

**Milazim Vitija** pyeti se a u votua kur është futur në rend të ditës kjo pika për shujta. Po e votuat edhe ju, me kontratën kolektive është vendosur që shujtat me iu pagua punëtorëve, të gjithë punëtorëve jo vetëm Komunës. Ne si Kuvend edhe vitin e kaluar, edhe këtë vit ne po dëshirojmë me i ndihmuar punëtorët e Komunës sepse janë në gjendje të rëndë materiale.

**Gëzim Sveçla** tha se ne kemi mendua që Jeta i ka sqaruar çështjet juridike të asaj lënde, në ndërkokë zyrtari ligjor tha që kështu nuk bën, unë thash po e ndalim sot, po e shohim se cila është mënyra ligjore dhe e votojmë të gjithë.

**Milazim Vitija** theksoi se edhe vitin e kaluar ne njëjtë e kemi ndarë.

**Gëzim Sveçla** tha se nuk e kishit ndarë njëjtë, e kishit ndarë si ndihmë diçka, jo shujtë.

**Valbona Makolli** dha sqarime, duke thënë se propozimi si ka ardhur nuk është që s'është ligjor, por ajo ka ardhur në atë formë që Ministria e Financave ka deklaruar se Komuna e Prishtinës në kategorinë e pagave dhe mëditjeve nuk ka mjete, mos të keqkuptohemi. Ajo ligjërisht është në rregull, kur është aspekti financiar gjithmonë Ministria e Pushtetit Lokal merr mendim ose kërkesën e bën tek Ministria e Financave. Ministria e Financave në vendim ka deklaruar kështu, që Komuna e Prishtinës për vitin 2022 nuk ka mjete për këtë kërkesë, d.m.th. nuk ka mjete ekstra pagave që janë të planifikuara.

**Mirsad Vitia** tha se d.m.th. sikur të kishte, ish aprovua.

**Valbona Makolli** po normal, atë kërkesë askush nuk mundet me e zbatua përvèç Ministrisë së Financave, Departamentit të Thesarit.

**Gëzim Sveçla** pyeti a i keni të planifikuara për vitin e ardhshëm, në vitin 2023 a mundemi me i realizuar shujtat për punëtorë.

**Valbona Makolli** u përgjigj varet krejt nga Ministria.

**Gëzim Sveçla**, ju po thoni që varet nga Ministria, a e kemi ditur atë ditë që varet nga Ministria?

**Valbona Makolli** dha sqarime.

**Milazim Vitija** bëri të ditur se me Ligjin për kontratat kolektive, në vitin 2010 është vendosur që sipas mjeteve buxhetore, shujtën me ua paguar punëtorëve, por pavarësisht asaj punëtorët kanë me fitua në Gjykatë.

**Leutrim Retkoceri** tha se tash i kemi ne dy situata të ndryshme, nëse përgjigja e tyre është që nuk janë të parapara me buxhet, unë kisha rekomanduar që Komuna duhet të ia kthej një përgjigje këtij Vendimi, me i thënë që për këtë çështje nuk mundemi me i parashikua ne në

### Faqe9ngall

buxhet, por në kuadër të këtij Vendimi mundësona që me rishikim me mundur me u zgjidhur kjo çështje që me mundur me kaluar.

**Gëzim Sveçla** tha se nen i 4 i Vendimit që e ka kthyer Ministria, pika 4 thotë: "Është evidentuar se organizata buxhetore në këtë rast është Komuna e Prishtinës, nuk i ka të planifikuara shpenzimet e përcaktuara me aktin komunal", ti nuk i ke pasur të ndara ato para për atë punë, e njësoj vlen edhe 2023 prapë nuk e ke.

Ai propozoj për seancë këto pikat e fundit, që janë "Pjetje dhe përgjigje" dhe "Të ndryshme" me i bërë bashkë, me e lënë vetëm një dhe me e vendosur të parën. Kuvendi komunal është forumi i vetëm ku mundet me u diskutua për problematikat e qytetit në mes të pozitës, opozitës, ekzekutivit. Mendoj se është shumë e rëndësishme, sepse zakonisht në këtë pjesën e parë të mbledhjes po marrin pjesë edhe drejtoret.

**Kryesuesi** tha se nuk pajtohem me Gëzimin, se nëse ata nuk rrinë deri në fund të seancës as në fillim nuk vijnë.

**Leutrim Retkoceri** u shpreh se në mandatin e kaluar ne e kemi provuar këtë formë, por nuk është realizuar. Nëse ne vendosim pika që nuk i njohim as vet, me i vendosur të parat, e këto të rregulltat me i vendosë pas, nëse ne i vendosim atëherë çfarë rëndësie ka që po takohemi, edhe këto pika të rendit të ditës që po i fusim.

**Gëzim Sveçla** bëri të ditur se ka kuvende komunale të cilat i aplikojnë këto.

**Leutrim Retkoceri** tha se me kuvende komunale edhe pse ligji e përcakton, unë nuk mendoj se Kuvendi komunal i Prishtinës është i barasvlershëm me Dragashin ose Podujevën.

Njëra prej gjërave që e kemi diskutuar në mandatin e kaluar për KPF, drejtoret të cilët nuk kanë qëndruar deri në fund të seancës ua kemi shtyrë pikat e rendit të ditës, nuk ua kemi përfshirë fare.

**Mirasad Vitia** tha se nuk kam qenë atëherë pjesë e KPF-së, por po më intereson p.sh. drejtori i Pronës a ka marrë pjesë nëpër mbledhje.

**Leutrim Retkoceri** u përgjigj se drejtori i Pronës kurrë nuk ka marrë pjesë në mbledhje.

**Gëzim Sveçla** tha se nuk e di cila është arsyja me iu ikur debateve dhe pyetjeve, këto nuk janë pyetje tona, janë pyetje të qytetarëve, përmes forumeve të ndryshme na i drejtojnë neve si adresë që ne me i parashtruar tek organet përgjegjëse për këto çështje.

**Leutrim Retkoceri** u përgjigj se ky model është në Kuvendin e Kosovës. Gjema një qytetar që e përcjellë Kuvendin e Kosovës prej fillimit e deri në fund.

**Gëzim Sveçla** tha dalloje pak deputetin me asambliston, ne jemi më të afërt me qytetarin se deputeti. Ne fillojmë prej lagjes, problemet e lagjes vijnë tek ti, unë, tek secili, d.m.th ne jemi më afër qytetarit sesa që është një deputet.

**Leutrim Retkoceri**, në parim duhet pas pyetje - përgjigje dhe duhet me qenë drejtoret aty, mos ta keqkuptojmë këtë pjesë e para, e dyta unë e kam tek rëndësia e pikave.

**Kryesuesi** tha si ide Gëzim çka ta merr mendja ty nëse këto pika i bëjmë bashkë edhe i bën pyetjet p.sh. paraprakisht, këto pyetje që ti i bën, me i bërë në emër të grüpuit një drejtori, cilit do, por me e bërë vetëm njëri e jo secili, nëse është në gjendje aty për aty me ju jep përgjigjur atëherë ja u jep, nëse nuk është ai, është i obliguar me shkrim me iu përgjigjur, te replikat, nuk kemi nevojë me bë replika ne, pse ti ki me bërë pyetje, unë kam me të dhënë përgjigje.

**Mirasad Vitia** po, por personi që t'i bën ndoshta 10 pyetje, nuk i ka informatat për ato pyetje, i ka tjetri.

**Kryesuesi** tha se unë pikërisht për atë thash me u koordinua me grupin tënd edhe e din, ato informata që i ka x-i t'i jep ty.

**Gëzim Sveçla** theksoi se ne nuk mundemi me kufizuar numrin e pyetjeve që një asamblist mundet me i bërë, nëse e ke kohën e kufizuar, mundesh edhe numrin e pyetjeve.

**Kryesuesi** shprehu mendimin se kjo mënyrë do të ishte mënyra më e mirë.

**Leutrim Retkoceri** tha se këtu ne duhet ndryshuar Rregulloren, është e domosdoshme që ajo rregullore me u ndryshuar, se nuk ka ndryshuar nga viti 2010, kështu që unë kisha propozua, formimin e një ekipi që ia fillon me punua për ndryshimin e rregullores. Me na thirrur jo vetëm KPF-ja, kish me qenë mirë me marrë më shumë anëtarë prej grupeve dhe me shkuar me punuar në ndryshim të rregullores. Nëse e vendos pastaj rregullorja dhe i ndanë modalitetet nga sa me ua kufizua, e kufizon rregullorja, e ti vetëm e respekton rregulloren, që mos me ardhur deri tek keqkuptimi, që me thënë ne KPF-ja kemi vendosur me ia kufizuar dikujt një pyetje ose dy.

**Kryesuesi** tha edhe kjo që unë e propozova, ne paraprakisht e dimë se çka kemi me pyetur, me grupin e vetë koordinohen, i caktojnë pyetjet të cilat kanë me i bërë, drejtori duhet me qëndrua në vend dhe është i obliguar me ju kthyte përgjigje. Nëse nuk e kthen një herë, dy herë, e largojmë pikën, bëhem bashkë dhe ia largojmë, nuk ia votojmë.

**Gëzim Sveçla** tha se nuk e di sa është demokratike kjo, me ia marrë të drejtën unë asamblistit pa marrë parasysh që jam shef i grupit, me i thënë po i bëj unë pyetjet, nuk po më duket në rregull.

**Leutrim Retkoceri** shprehu mendimin se duhet me ia dhënë hapësirë asamblistëve me folur. Vetëm te kjo konkrete, kryesues t'u kisha lutur, kur ke kohë me e bërë një takim për rregullore për me e ndryshuar edhe kësaj me i dhënë rrugë e mos me mbetur anash.

*Mbledhja përfundoi në orën 11:30.*

Procesmbajtësja  
Shyrete Islami

Kryesuesi i Komitetit  
Fehmi Kupina



Faqe 11 nga 11